



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

01 - Nr. 16-16838/13.
Kaçanik, 04.07.2013

Në bazë të nenit 5,12 dhe 17 dhe 40.2 të Ligjit nr. 03/L-040 - Për Vetëqeverisjen Lokale, të nenit 6 (k) dhe 34.5 të Statutit të komunës së Kaçanikut, i datës 25.09.2008, të propozim vendimit të kryetarit të komunës, 01Nr. 16-16838/2013 të datës 28.06.2013, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur me datë: 04.07.2013, merr këtë:

V E N D I M

PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORËS 01-Nr. 05-8253/10 - PËR CAKTIMIN E ORARIT TË PUNËS PËR SUBJEKTET AFARISTE NË TERRITORIN E KOMUNËS SË KAÇANIKUT

Neni 1

1.1. Me këtë Vendim, ndryshohet dhe plotësohet Rregullorja 01- Nr. 05-5318/2010 - Për caktimin e orarit të punës për subjektet afariste në territorin e komunës së Kaçanikut, e aprovuar nga Kuvendi i Komunës së Kaçanikut më datën 30.06.2010.

1.2. Neni dhe paragrafët e Rregullores që ndryshohen janë paraqitur në nenin 2. të kësaj Rregulloreje, duke u përshkruar teksti ekzistues dhe teksti i cili propozohet të ndryshohet dhe plotësohet (zëvendësohet).

Neni 2

2.1. Propozohet të shlyhet teksti ekzistues te neni 4, te paragrafi 4.2.2. - Orari i punës së barnatoreve

Teksti ekzistues:

Orari i punës së barnatoreve:

- periudha verore dhe dimërore prej orës **08.00 - 24.00**.

Një barnatore farmaceutike, do të kujdestaroj ditëve të dieleve dhe gjatë natës, ndërsa orarin e kujdestarisë në kohëzgjatje mujore do ta përcaktojnë vet pronarët e barnatoreve në bashkëpunim me Drejtorinë e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit.

- Orari i kujdestarisë caktohet sipas alfabetit të mbishkrimeve të barnatoreve si dhe kanë obligim që secila barnatore, orarin ta vendos në vend të dukshëm në hyrje të saj.

2.2. Propozohet të zëvendësohet me tekstin e ri :

Orari i punës së barnatoreve farmaceutike fillon për :

- periudhën verore prej orës 08.00 – 22.00
- periudhën dimërore prej orës 08.00 – 20.00

(Përcaktimi i kohëzgjatjes kohore të periudhës verore dhe dimërore është në harmoni të plotë me matjen kohore verore dhe dimërore në nivel të vendit)

Të dielave barnatoret farmaceutike nuk punojnë, përveç barnatorja që mbanë kujdestari.

- Në kujdestari do të përfshihen të gjitha barnatoret farmaceutike në sistem rotacioni për çdo ditë, me zbatim pas përfundimit të orarit të rregullt dhe ditëve të diela.
- Orari i mbajtjes së kujdestarisë në veçanti për secilën barnatore farmaceutike do të përcaktohet për çdo muaj me kompetencë të plotë nga Drejtoria Komunale për Shëndetësisë dhe Mirëqenie Sociale.

Neni 3

Këto plotësime dhe ndryshime do të përfshihen në tekstin bazë të rregullores komunale dhe do të zbatohen menjëherë pas miratimit nga Kuvendi i Komunës.

**Kryesuesi i Kuvendit,
Xhelal Gashi**

